



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 44/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga :Vedat Poterqoi Kryetar, Agon Ramadani Anëtarë dhe Kimete Gashi Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Alb -Architect" sh.p.k, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 iniciuar nga AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 08.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Hedhet si e palejuar, ankesa e OE "Alb -Architect" sh.p.k, me seli në Prishtinë e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 18.01.2023 (me numër protokollit 44/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2 iniciuar nga AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

2.I Lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2.

3.Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej

gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.12.2022, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë Shërbimet Konsulente Procedurë e Kufizuar Faza Dytë për aktivitetit të prokurimit me titull: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2. Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë data 19.01.2023.

Me datë 13.01.2023 Operatori Ekonomik “Alb -Architect” sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Prishtinë, me datë 16.01.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues si të jashtë ligjshme.

Po ashtu me datë 16.01.2023 OE ankues e përsërit kërkesën për rishqyrtim, AK Komuna e Prishtinës, e Hedhë si të jashtë afatshme kërkesën për rishqyrtim.

Me datën 18.01.2023 Operatori Ekonomik “Alb -Architect” sh.p.k ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 44/2023, kundër kërkesave diskriminuese të vendosura në Njoftimit për Kontratë të publikuar me datën 21.07.2022 dhe Dokumente te Tenderit të publikuara përmes platformës e-prokurimi me datën 08.12.2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar Shërbimet Konsulente, Procedurë e Kufizuar-Faza 2 vlera e parashikuar e kontratës:12,000,000.00 €

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me pikën 6 të nenit 108/A dhe në 109 të LPP-së, lidhur me pika 9 paragrafi 1 te nenit 111 te LPP-së dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur të gjitha dokumenteve të ngarkuara në e-prokurim, për ankesën në fjalë Paneli konstatoi në vijim se:

Me 08.12.2022, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë Shërbimet Konsulente Procedurë e Kufizuar Faza Dytë për aktivitetit të prokurimit me titull: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2. Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë data 19.01.2023. Ndërsa, me datë 13.01.2023 në ora 15:51, Operatori Ekonomik

“Alb -Architect” sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Prishtinë, që i bie të jetë në ditën dhe minutat e fundit të afatit të lejuar për parashtrim të kërkesës për ri-shqyrtim.

Pavarësisht kësaj, kërkesa për ri-shqyrtim nuk përmban asnjë pretendim ankimor apo ndonjë shkelje të supozuar të ndonjë dispozite ligjore, por përmban vetëm faqen e parë të formularit të saj dmth identifikimin e aktivitetit të prokurimit dhe identifikimin e operatorit ekonomik si dhe dokumentet tjera të cilat kanë figuruar edhe në e-prokurim si: Njoftimin për kontratë, procesverbalin e hapjes së fazës së parë, njoftimin sa i përket kandidatëve që hyjnë në listën e ngushtë për fazën e parë, ku është i përfshirë edhe vetë OE ankues, kërkesa për informacione shtesë dhe një vendim i AK për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim të një OE tjetër i muajit gusht të vitit 2022, për fazën e parë. Për panelin shqyrtues një kërkesë e tillë është e pavlefshme dhe jo ligjore dhe me të drejtë AK e ka vendos si kërkesë të paligjshme.

Me datë 16.01.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim të OE ankues si të jashtë ligjshme, kundër të cilës OE nuk bënë ankesë në OSHP, por bënë kërkesë për ri-shqyrtim prapë më dt. 16.01.2023 në autoritet kontraktues dhe si të tillë AK me dt. 17.01.2023, e hedhë si të jashtë afatshme. Tek pas hedhjes së kësaj kërkesë për ri-shqyrtim, OE ankues parashtron ankesë në OSHP.

Nga faktet e prezantuara si më lart paneli shqyrtues konstaton se kërkesat për ri-shqyrtim të OE ankues “Alb -Architect” sh.p.k e datës 13.01.2023, është jo ligjore sepse nuk përmban as elementet qenësore dhe formën ligjore që duhet të përmbajë Formulari standard (F02) për paraqitje të një kërkesë për ri-shqyrtim tek autoriteti kontraktues ashtu siç e përcakton edhe Rregullorja nr.001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht neni 60, paragrafi 1, i cili citon: *“Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik”*. Ekzistojnë raste tjera të ngjashme kur disa nga informacionet në këtë formular mungojnë, atëherë mund të kërkohen informacione shtesë konform nenit paragrafit 4 dhe 5 të nenit 108/A të LPP, por në këtë rast mungon e gjithë korniza apo pjesa kryesore dhe kompletimi i tërësishëm i formularit.

Tutje, afati i paraparë për hapje të ofertave ka qenë dt. 19.01.2023, ndërsa kërkesa e dytë për ri-shqyrtim është pranë autoritetit kontraktues bërë me dt. 16.01.2023, PSh e klasifikon si të jashtë afatshme konform nenit 108/A të LPP-së dhe Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht nenit 60, paragrafi 1, pika a), e cila citon: *“Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).”*

- Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe paragrafin 6 te nenit 108/A, 109 dhe nenin 111 të LPP-

së dhe përfundimisht konstatoj se kërkesat që i paraprijnë një procesi ankimor të parashtruar në OSHP- nga OE "Alb -Architect" sh.p.k janë jo ligjore dhe e jashtëafatshme, andaj, ankesa e OE ankues nuk shqyrtohet nga PSH por kjo ankese hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka ushtruar këtë ankesë në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe 111 të LPP-së.

Ndërsa, përgjegjësini për ndonjë shkelje eventuale të dispozitave ligjore përgjegjësini e mban vetë autoriteti kontraktues si iniciues i këtij aktiviteti të prokurimit.

Vendimi si ne piken 3 te këtij vendimi u mos në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së .

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës
- 1x1 OE "Alb -Architect"sh.p.k, me seli në Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.